UDHËZIM
Nr. 16, datë 5.11.2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 338/3, DATË 10.3. 2006, MBI ZBATIMIN E VKM NR. 787, DATË 14.12.2005 "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË MASËS SË NDIHMËS EKONOMIKE"

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, dhe në zbatim të pikës 38 të vendimit nr. 787, datë 14.12.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pika 1, germa "e" e kapitullit IV, të udhëzimit nr. 338/3, datë 10.03.2006, "Mbi zbatimin e VKM nr. 787, datë 14.12.2005, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike", zëvendësohet me këtë përmbajtje:

"e" personat punëkërkues të papunë që refuzojnë vende pune apo pjesëmarrje në programe të tjera shtetërore. Për këta persona, administratori pas konfirmimit të marrë, nuk vazhdon procedurat e mëtejshme për përfitimin e ndihmës ekonomike".

2. Në pikën 2 të kapitullit XI, pas paragrafit "projektvendimi do të përmbajë: nr. rendor, emrin dhe mbiemrin e kryefamiljarit....", shtohet dhe emër mbiemër i bashkëshortes (sipas formularit bashkëngjitur).

3. Në pikën 5 të kapitullit XI, pas paragrafit "vendimi do të përmbajë: nr. rendor, emrin dhe mbiemrin e kryefamiljarit....", shtohet dhe emër mbiemër i bashkëshortes (sipas formularit bashkëngjitur).

4. Në pikën 7 të kapitullit XI, pas paragrafit "borderoja do të përmbajë: nr. rendor, emrin dhe mbiemrin e kryefamiljarit.....", shtohet dhe emër mbiemër i bashkëshortes (sipas formularit bashkëngjitur).

5. Pika 17 e kapitullit XI ndryshohet si më poshtë vijon:

"17. Ndihma ekonomike e familjes përfituese tërhiqet pranë sporteleve të bankave/Postës Shqiptare nga bashkëshortja. Në rastet kur bashkëshortja ka ndërruar jetë, ndihma ekonomike tërhiqet nga kryefamiljari".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQËNIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj

LISTA QË I BASHKËNGJITET PROJEKT VENDIMIT

Prefektura_____

Rrethi_____

Bashkia, Komuna _____

Lista që i bashkëngjitet projektvendimit ne total të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike për periudhën e akorduar

Nr	Emri atësia Mbiemri	Emri atësia mbiemri bashkëshortes	Nr dosjeve	Nr frymëve	Lloji i Ndihmës	Shuma përfituese
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						

Shefi i ndihmës ekonomike
Emri, Atësia, Mbiemri firma

Administratorët Shoqëror
Emri, Atësia, Mbiemri Firma

LISTA QË I BASHKËNGJITET VENDIMIT

Prefektura_____

Rrethi_____

Bashkia, Komuna _____

Lista që i bashkëngjitet vendimit ne total të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike për periudhën e akorduar

Nr	Emri atësia Mbiemri	Emri atësia mbiemri bashkëshortes	Nr dosjeve	Nr frymëve	Lloji i Ndihmës	Shuma përfituese
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						

Sekretari i Këshillit

Emri, Atësia, Mbiemri firma

Kryetari i Këshillit

Emri, Atësia, Mbiemri Firma

BORDERO E PAGESËS SË NDIHMËS EKONOMIKE

Prefektura_____

Rrethi_____

Bashkia, Komuna _____

Bordero e pagesës së ndihmës ekonomike

Për periudhën _____ 20_____

Nr	Emri atësia Mbiemri	Numr i ID	Emër Atësia Mbiemër bashkëshortes	Nr dosjeve	Nr frymë ve	Lloji i Ndihmës	Shuma përfituese	Nr llogarisë bankare së bashkëshortes *
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								

Shefi i ndihmës ekonomike
Emri, Atësia, Mbiemri firma

Administratorët Shoqëror
Emri, Atësia, Mbiemri Firma

*Në rast se bashkëshortja ka vdekur vendost nr i llogarisë së kryefamiljarit